

shkuar në Pejë/Peç në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak. Me njësitin e tij ishte i dislokuar në **Deçan/Deçane**. Herën e fundit iu lajmërua prindërve më 15.07.1998. Në natën e datës **17.07.1998**, Ivani i caktonte ushtarët për rojë që mbahej në istikamet përreth qytetit. Kur nga ora 23:00, iu afrua njërit nga vendet vrojtuese, një pjesëtar i UJ-së ka shtënë ndaj tij aksidentalisht duke menduar se bëhej fjalë për një person të panjohur. Ivani ka mbetur i vdekur në vend. Kufoma e ushtarit të vrarë i është dorëzuar familjes më 19.07.1998. Një ditë më vonë, ai u varros në varrezat e qytetit Paliq.

Burimet: deklarata P.M, FDH-31329; MKTJ, ICTY, IT-05-87, (Milutinović dhe të tjerë), EX.5D01305 FDH-31370; MO, *Spisak 40 pripadnika VJ.*, FDH-28075.

Halit (Sylë) Krasniqi

(1920, shqiptar nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, tetë fëmijë)

Në fillim të muajit maj të vitit 1998, bashkëshortja e Halitit, Gjyjkja, dhe familja e të birit, i cili punonte në Zvicër, kaluan në fshatin Pacaj [Gjakovë/Đakovica]. Haliti nuk desh të largohej nga shtëpia në Junik. Bashkëshortja dhe e reja e vizitonin gati çdo ditë, duke i çuar ushqime. Por, kur shkuan te ai më **17.07.1998**, e gjeten trupin e pajetë të Halitit në oborr [Junik]. Ishte i qëlluar me një plumb në kokë. Po atë ditë, bashkëshortja dhe disa pjesëtarë të UÇK-së e varrosën atë në varrezat e fshatit, ku prehet edhe sot.

Burimi: deklarata N.K, FDH-19235.

Bajram (Ramë) Shehu

(1920, shqiptar nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, gjashtë fëmijë)

Bajrami i moshuar jetonte me dy djemtë e tij dhe familjet e tyre. Djemtë ishin pjesëtarë të UÇK-së dhe shkonin për ditë për të mbajtur pozicione të veta në fshatin Junik. Bajramin e vranë më **17.07.1998**, në oborrin e shtëpisë së tij në **Junik**. E qëlluan me plumba nga shpina. Plumbat i kaluan afër zemrës. Pasi e gjetën të vdekur në oborr, djemtë e varrosën atë në livadhin e

kushëririt Qazim Shehut. Pas përfundimit të luftës, më 2.08.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Bajramit në varrezat e Junikut/Junik.

Burimi: deklarata M.S, FDH-19234.

Jordan (Hristivoje) Stojanović

(17.09.1973, serb nga Çapljinci, komuna e Doljevacit, axhustator, pjesëtar i UJ-së)

Jordani ushtronte futboll, karate dhe xhudo. Në vitin 1994, ka filluar të punonte si ushtar me kontratë në Ushtrinë e Jugosllavisë. E caktuan në Batalionin e Tretë të Ushtrisë Policore. Një kohë ishte me detyrë në kazermën në lagjen *Bubanj* në Nish. Në muajin mars të vitit 1998, e dislokuan në **postbllokun kufitar të Gjeravices/Đeravica** [Deçan/Deçani]. Në mesnatë mes datave 17 dhe 18.07.1998, Jordani ishte në përbërje të një grupi prej gjashtë ushtarësh, i cili po e mbante rojën. Herët në mëngjes të ditës së nesërme, më **18.07.1998**, u nisën në sulm kundër një grupi pjesëtarësh të UÇK-së që ishin të fshehur në afërsi të postbllokut. Gjatë betejës, atë e qëlluan me plumb në ballë. Bashkëluftëtarët e kanë tërhequr me vete një orë më vonë. Ishte në gjendje të pavetëdijshme për afro dhjetë ditë. Më 28.07.1998, dha shpirt në AMU në Beograd. E varrosën më 30.07.1998 në varrezat e fshatit në Çapljincë, të cilat ndodhen përballë shtëpisë së tij familjare.

Burimet: daklarata H.S, FDH-25859; ICTY, IT-05-87 (Milutinović dhe të tjerë), EX.5D01305, FDH-31370; KKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 67, 68.

Ramadan (Beqir) Fazliu

(5.08.1954, shqiptar nga fshati Dalak/Doljak, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ramadani ka qenë veprimtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Policia serbe e keqtrajtoi shpesh fizikisht. Në fillim të muajit qershor të vitit 1998, u inkuadrua në UÇK. I furnizonte me ushqime banorët e *Drenicës/Drenica*. Me disa miq, ka shkuar në Shqipëri më 1.07.1998. I kishte të veshur rrobat civile. Nuk ishte i